



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

KF.nr.104/22

GJYKATA KOMERCIALE, Dhomat e shkallës së parë, Departamenti Fiskal, me gjyqtarin Fisnik Nuli, dhe me bashkëpunëtorin profesional Visar Gashi, në kontestin tregtar administrativ, të paditësit N.T.P. “B...” me seli në Bërrnicë të ulët, Prishtinë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson J.O Avokat në Prishtinë, kundër të paditurit Dogana e Kosovës në Prishtinë, me bazë juridike - anulim vendimi, objekt kontesti – Akcizë, vlerë kontesti e pa përcaktuar, në seancën e shqyrtimit gjyqësor kryesor publik të mbajtur, me datë 26.10.2022, në prani të përfaqësuesit të autorizuar të paditësit Avokat J.O dhe të përfaqësuesit të autorizuar të palës së paditur M.K, mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET kërkesëpadia e paditësit N.T.P. “B...” me seli në Bërrnicë të ulët, Prishtinë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson J.O Avokat në Prishtinë, si e bazuar.
- II. ANULOHET vendimi nr. 01.3.2.2/14374 i datës 17.11.2020 i Doganës së Kosovës dhe lënda KTHEHET NË RISHQYRTIM DHE RIVENDOSJE.
- III. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale

A R S Y E T I M

Paditësi N.T.P. “B...” me seli në Bërrnicë të ulët, Prishtinë, përmes të autorizuarit të tij me padinë e paraqitur në Gjykatë me datë 21.12.2020, ka iniciuar kontestin tregtar administrativ kundër të paditurës Dogana e Kosovës në Prishtinë, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të KDA-së, dhe ligjit për procedurën e përgjithshme administrative, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me të cilën i ka propozuar gjykatës të aprovohet kërkesëpadia si e bazuar, të anulohet aktvendimi kontestues të ndryshohet ose të lejohet kthimi i mjeteve të paguara më tepër. Në seancën e shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i autorizuar i paditësit deklaroi se. Sqarojmë se lidhur me

pretendimet e të paditurës se ka pasur kontroll të paralajmëruar nuk qëndrojnë, pasi që edhe në vetë arsyetimin e vendimit nr.2020-03/05.06.2020 qysh në faqen e dytë në paragrafin e parë thuhet se “Është realizuar një vizitë Kontroll pa paralajmërim me datë 02.10.2019”. Në kuptim të kësaj paditësit nuk i është dhënë kohë që ti prezantoj të gjitha dokumentacionet e nevojshme me qëllim të sqarimit se ku gjendet malli i dhënë me konsignacion dhe as dhënien e dokumenteve që dëshmojnë vjedhjen e mallit si më lartë. Sa i përket dëmtimeve të banderolave të cilat pretendon e paditura, në rast se do të kishte këso dëmtime do të kishte edhe procedurë penale në këtë rast, mirëpo deri në këtë fazë nuk kemi njohuri se është iniciuar një procedurë e tillë ndaj këtu paditësit. Tutje sqarojmë se njoftimet e rregullta mujore gjithmonë janë dorëzuar tek e paditura. Gjithashtu në ditën kritike janë dorëzuar edhe faturat e shitjes së mallit kontestues si dhe mallit në tërësi. Ditën kritike paditësit nuk i është ofruar asnjë raport lidhur me të gjeturat e oficerëve doganor në vend shikim, e të cilin raport as deri në ditën e sotme nuk e kemi pranuar, e që besoj se është e nevojshme për sqarimin e saktë lidhur me të gjeturat e oficerëve doganor në vend shikim, pasi që ky raport është dashur të përpilohet në vend shikim dhe të nënshkruhet edhe nga vet pronari apo përfaqësuesi i subjektit në procedurë, këtu paditësi. Andaj, në kuptim të lartcekurave propozojmë gjykatës që këtë aktvendim të atakuar ta anulojë si të paligjshëm dhe jo të bazuar, dhe lëndën ta kthejë në rishqyrtim pranë të paditurës, ashtu që e njëjta të marrë për bazë të gjithë dokumentacionin e paditësit, përfshirë e dhe atë dorëzuar tani në këtë seancë, dhe vetëm pas kësaj dhe mbi bazën e kësaj të nxjerrë një vendim të drejtë dhe të bazuar në ligj. Shpenzimet e procedurës i kërkon.

E paditura, në përgjigje në padinë të datës 07.12.2021 e konteston në tërësi si të pa bazuar kërkesëpadinë e paditësit. Aktvendimi i atakuar është marr komfor të të gjitha dispozitave në fuqi dhe ajo në të cilën pretendon pala se ky vendim është marrë me shkelje ligjore nuk qëndron fare, me arsyetimin se vendimi i kontestuar është marrë konform legjislacionit në fuqi dhe në mënyrë të drejtë ndërsa pala paditëse pretendimet e veta nuk i ka vërtetuar as edhe me një provë të vetme. Përfaqësuesi i autorizuar i paditësit në seancën e shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare deklaroi se : Në bazë të raportit të cilin e ka bërë Sektori i Akcizave, bazuar në një vizitë të paralajmëruar për këtu paditësin të datës 02.10.2019 tek subjekti – këtu paditësi, i njëjti nuk ka arritur që të prezantoj dokumentacion për shkeljet e evidentuar siç u cekën edhe

më lartë mungesë e 1440 copë banderola të pavendosur në pije dhe 6204 copë banderola të ndara (dëmtuara). Në bazë të autorizimit subjekti ka për obligim që ta njoftojë Doganën për çdo ndryshim në bazë të pikës së 10-të të autorizimit DMA nr.37, paragrafi i fundit thuhet se “Për çfarëdo ndryshimi që ka të bëjë me autorizimin, është obligim i bartësit të autorizimit që të njoftoj paraprakisht Sektorin e Akcizave, këtu Doganën”. Pra, autorizimi i DMA nr.37 i cek të gjitha obligimet e bartësit të autorizimit ndaj Doganës. Gjithashtu, pretendimet e subjektit se kemi të bëjmë me vjedhje nuk janë mbështetur me asnjë provë në lëndë dhe as nuk janë paraqitur zyrtarëve doganor me rastin e realizimit të vizitës në Depon e këtu paditësit, as gjatë procedurës ankimore, dhe siç u vërtetuar edhe në këtë seancë, as tani në këtë lëndë. Shpenzimet e procedurës nuk i kërkon.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, Gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit gjyqësor kryesor-publik, ka administruar provat dhe atë: Aktvendimet nr.14374/17.11.2020, nr.2020-03/05.06.2020, Kërkesa për Rishqyrtim e ushtruar në Doganën e Kosovës e datës 10.11.2020, Autorizimi i Objektivit për Depo të Mallrave me Akcizë DMA nr.37/25.02.2020, Faturat 0012147, 010426, 000115, 0012142, 0091552, 0091551, 0018539, Përgjigja në Padi e datës 07.12.2021, Raportimi Mujor për Muajin Shtator, Tetor 2019, dhe Shtator 2022, e-mail-at e datës 16.11.2020 dhe 13.11.2020, Marrëveshjet për Kompensim të datës 30.01.2020 dhe 30.01.2021, Marrëveshja për Shitjen e Mallit e datës 31.05.2019, Libri i Shitjes për Muajin Janar dhe Shkurt 2020, dhe Janar 2021, Formularët e Deklarimit të TVSH-së për Muajt Janar dhe Shkurt 2020, për Muajin Janar 2021, Kërkesa për Korrigjim e datës 30.07.2021, 02.08.2021, DUD-at R-1037/03.02.2020, R-1285/03.02.2021.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues, thëniet në padi dhe seancë, përgjigje në padi, shkresave të lëndës në këtë konflikt administrativ, bëri ballafaqimin e provave që kanë ofruar të dy palët, dhe bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave se bashku, mbështetur edhe në dispozitat nga neni 8, të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK-së), dhe arriti në përfundimin se në këtë konflikt administrativ, duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për këto arsye:

Nga provat e administruara në këtë konflikt administrativ, nga Aktvendimi 14374/17.11.2020, i Doganës se Kosovës, deklarimeve në padi, shkresat e lëndës,

aktvendimi kontestues, dhe deklarimeve në seancën e shqyrtimit kryesor, Gjykata ka gjetur se nuk është kontestues fakti se e paditura ka ushtruar kontroll të pa paralajmëruar tek këtu paditësi me datë 02.10.2019, me ç ‘rast ka konstatuar parregullsi, e për të cilat parregullsi është lëshuar edhe aktvendimi 2020-03 i datës 05.06.2020. Jo kontestuese mbesin edhe faktet se paditësi, ka ushtruar ankesë pranë Doganës së Kosovës, e për të cilën ankesë, Dogana e Kosovës me datë 17.11.2020, ka sjell Aktvendimin nr. 01.3.2.2/14374 si akt administrativ përfundimtar i nxjerrë në procedurën administrative në shkallë të dytë, me të cilin është refuzuar kërkesat e subjekti në procedurë, e kundër të cilit, paditësi me padinë e datës 21.12.2020, ka iniciuar kontestin tregtar administrativ pranë kësaj gjykate.

Nga ekzaminimi i vendimit kontestues, Gjykata konstaton se e paditura Dogana e Kosovës në shkallë të dytë e ka refuzuar kërkesën e subjektit në procedurë këtu paditësit, për rishqyrtimin e aktvendimit 2020-03 i datës 05.06.2020. E paditura ka vlerësuar se këtu paditësi ka bërë shkelje të Autorizimit për depo të mallrave me akcizë, ngase me rastin e vizitës së realizuar nga inspektorët e Doganës këtu paditësi të njëjtëve nuk i’u ka prezantuar: Stokun, daljet regjistrim për pije dhe shitje ambulante, e e cila ka rezultuar me gjendjen e konstatuar nga këtu e paditura me rastin e vizitës në depon e mallrave me akcize me datë 02.10.2019.

Gjykata nga aktvendimi kontestues vëren se ai përmban të meta të cilat e pengojnë vlerësimin e ligjshmërisë së vendimit të kontestuar, te metat e tilla konsistojnë në faktin se arsyetimi i vendimit kontestuese përmban të dhëna te pamjaftueshme dhe jo të plota sa i përket shkeljeve të autorizimit për depo të mallrave me akcizë. Në arsyetimin kontestues nuk është dhënë arsyetim i bazuar, përse nuk i është dhënë kohë kontabilistit të këtu paditësit që ka qenë prezent me datë 02.10.2019, kur edhe është realizuar kontrolli nga këtu paditësi për të paraqitur dëshmitë me qëllim të sqarimit se ku gjendet malli i dhënë me konsignacion dhe dokumenteve që dëshmojnë vjedhjen e një pjese të mallit, përse nuk është përpiluar proces mbi konstatimin e gjendjes faktike në vendshikim, dhe përse nuk janë bërë fotografi të banderolave të dëmtuara.

Mos vërtetimi i plotë i gjendjes faktike, Gjykata e konsideron faktin se vendimi i kontestuar nuk përmban arsye për faktet vendimtare të vlefshme për gjykimin e drejtë

të kësaj çështje juridike-administrative. Në arsyetim të vendimit kontestues, thuhet se Sektori i Akcizës ka vepruar drejtë kur me Aktvendimin e lartcekur ka obliguar subjektin në procedurë që të paguaj taksën e akcizës në shumë prej 14,240.58 euro pasi që pas vizitës nga ky sektor është hasur në parregullsi tek gjendja faktike e stokut, mungesë e 6204 copë banderola të ndara (keqpërdorur), ndërsa pijë raki kumbulle, rrushi, kajsie, maline, gjini dhe molle me rastin e numërimit ka hasur më pak në 3,749L, kurse sasia e pijeve alkoolike është 245.27 L më shumë, mirëpo një konstatim i tillë për Gjykatën është kontradiktor në vetvete dhe në raport me dokumentacionin e prezantuar, si dhe me bazën ligjore në fuqi, përderisa paditësi në këtë konflikt administrativ ka paraqitur prova dhe atë Autorizimin e Objektivit për Depo të Mallrave me Akcizë DMA nr.37/25.02.2020, Faturat 0012147, 010426, 000115, 0012142, 0091552, 0091551, 0018539, Raportimi Mujor për Muajin Shtator, Tetor 2019, dhe Shtator 2022, e-mail-at e datës 16.11.2020 dhe 13.11.2020, Marrëveshjet për Kompensim të datës 30.01.2020 dhe 30.01.2021, Marrëveshja për Shitjen e Mallit e datës 31.05.2019, Libri i Shitjes për Muajin Janar dhe Shkurt 2020, dhe Janar 2021, Formularët e Deklarimit të TVSH-së për Muajt Janar dhe Shkurt 2020, dhe për Muajin Janar 2021, Kërkesa për Korrigjim e datës 30.07.2021, 02.08.2021.

Gjykata e obligon të paditurën se në rishqyrtim dhe rivendosje, duhet te konstatoj këto pretendime të cekura si më lartë dhe argumentet e paditësit dhe të deklarohet lidhur me provat e administruara përkatësisht Autorizimin e Objektivit për Depo të Mallrave me Akcizë DMA nr.37/25.02.2020, Faturat 0012147, 010426, 000115, 0012142, 0091552, 0091551, 0018539, Raportimi Mujor për Muajin Shtator, Tetor 2019, dhe Shtator 2022, e-mail-at e datës 16.11.2020 dhe 13.11.2020, Marrëveshjet për Kompensim të datës 30.01.2020 dhe 30.01.2021, Marrëveshja për Shitjen e Mallit e datës 31.05.2019, Libri i Shitjes për Muajin Janar dhe Shkurt 2020, dhe Janar 2021, Formularët e Deklarimit të TVSH-së për Muajt Janar dhe Shkurt 2020, dhe për Muajin Janar 2021, Kërkesa për Korrigjim e datës 30.07.2021, 02.08.2021. Në arsyetimin e vendimit kontestues shihet se e paditura nuk ka konstatuar saktë gjendjen faktike dhe as shqyrtuar drejtë pretendimet e paditësit ngase një gjë të tillë e ka cekur edhe vet e paditura në vendimin kontestues kur ka theksuar se “Sektorit të Akcizës, subjekti në procedurë nuk i ka ofruar (prezantuar), stokun, daljet-regjistrat për pijë me shitje ambulante në ditën që ishin për vizitë njësi të pijeve alkoolike nga SA, kurse sipas raportit mujor të shtatorit stoku

me datë 30.09.2019 ka qenë 10.057.62 L”, andaj një akt administrativ i tillë nuk përmban një përmbledhje të konstatimeve faktike bazuar në provat e paraqitura gjate procedimit administrativ ose në faktet e siguruara nga Organi Administrativ i të paditurës .

Të metat e mësipërme janë të asaj natyre që e bëjnë të pa mundur vlerësimin e ligjshmërisë së vendimit të kontestuar, prandaj aktvendimi i atakuar u deshtë që doemos të anulohet, tutje Gjykata e obligon të paditurën që në ri procedurë të deklarohet edhe lidhur me provat e paraqitura nga paditësi në këtë kontest tregtar administrativ dhe atë Marrëveshjen e Shitjes së Mallit me Konsignacion të datës 31.05.2019, si dhe Marrëveshjet për Kompensim të datës 30.01.2021 dhe 30.01.2020, si dhe dokumentacioni përcjellë nga libri i shitjes së paditësit, Formularin e deklarimit të TVSH-së për këtë mall, Dokumentin Unik Doganor R-1037/03.02.2020 dhe R-1285/03.02.2021, si dhe dokumentacionin përcjellës për këtë mall siç janë Faturat.

Me rastin e nxjerrjes së vendimit të ri, e paditura të vlerësoj drejt gjendjen faktike që rezulton nga vizita në vendngjarje e mbuluar me procesverbal, me fotografi përkatëse, dhe nga dokumentacioni i mallit, si dhe të deklarohet veç e veç lidhur me provat e prezantuara nga këtu paditësi dhe të aplikoj drejt dispozitat ligjore të KDAK-së 03/L-109, nenet 246 deri 249, dhe të Udhëzimeve Administrative për zbatimin e këtyre dispozitave të KDA-së, me të cilën përcaktohet kushtet për depo të autorizuar për mallrat me akcizë. Vërejtjet e cekura janë të obligueshme për organin e paditur, duke u bazuar në nenin 65, të Ligjit për Konfliktet Administrative.

Gjykata vendos për çështjen e konfliktit administrativ në bazë të fakteve të vërtetuara në procedurë administrative, në vështrim të nenit 43, paragrafi 1, të LKA-se. Në bazë të këtij parimi, Gjykata e ka të pamundur të vendos në mënyrë meritore në këtë konflikt administrativ për arsye se ekzistojnë të meta të cilat e pengojnë vlerësimin e ligjshmërisë së vendimit të kontestuar, andaj e aprovon padinë e paditësit, anulon aktvendimin e kontestuar, dhe lënda kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje.

Vendimi që secila palë t’i bart shpenzimet e veta procedurale është marrë konform nenit 64, të LKA-së.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, Gjykata konform dispozitave ligjore të nenit 43, par 2, e 46, par 1 dhe 2, të LKA-së, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE

Dhomat e shkallës së parë, Departamenti Fiskal

KF.nr.104/22 datë 26.10.2022

Bashkëpunëtori Profesional
Visar GASHI

Gj y q t a r i,
Fisnik NULI

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh nga marrja e të njëjtit, dhomave të shkallës së dytë, përmes dhomave të shkallës së parë të kësaj gjykate.